

(Pic: Reuters)



GRATË DHE SIGURIA NË PUNË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

19 Tetor, 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

PARTNERËT:

# Gratë dhe Qasja në Punë

Nga: Besa Kabashi-Ramaj, QHDP

Gratë dhe Siguria e Punës në Sektorin Privat në Kosovë është një pilot projekt i cili ka për qëllim: Ngritjen e vetëdijës së grave në sektorin privat mbi implikimet e ligjit të ri të punës dhe të drejtat e tyre në kuadër të këtij ligji; rritjen e vetëdijës në mesin e institucioneve qeveritare mbi pozitën e grave në sektorin privat, sidomos pas fillimit të implementimit të ligjit të ri të punës, si dhe implikimet; dhe Avokimin me sektorin privat lidhur me benefitet afatgjate të ngritjes së numrit të grave në sektorin privat.

Qëllimi është të vihen në pah sfidat e të gjithë akterëve dhe përfituesve të projektit (gratë, institucionet, dhe sektori privat) në implementimin e ligjit të ri të punës, si dhe politikave tjera në praktikë, sa i përket grave, si dhe arritja të rekomandimet konkrete për ndryshimet që duhen bërë për të adresuar sfidat e identifikuar.

Deri tani janë mbajtur 2 takime konsultative me akterë dhe janë identifikuar sfidat si dhe diskutuar rekomandimet potenciale për adresimin e sfidave.

## SFIDAT

Si rezulta i politikave që shteti ka adoptuar, gratë në Kosovë për momentin janë në një pozicion të disfavorshëm sa i përket

punësimit dhe avancimit të karrierës, rolit të tyre në familje, potencialisht janë më të ekspozuara ndaj dhunës në familje, si dhe mundësisë për të participuar në jetën publike.

Trajtimi i rolit të gruas në shoqëri dhe shtetëndërtim në përgjithësi e pozicionon gruan si barrë dhe jo si një ndër akterët kryesorë në evoluimin e familjes, shoqërisë si dhe mbrojtjen dhe zhvillimin e shtetit dhe sigurisë së tij.

Participimin i grave në tregun e punës, si dhe participimi aktiv në punë, në krahasim me meshkujt paraqet një diskrepancë të madhe.

Rënia e shpejtë e natalitetit riafirmon se si trajtimi joadekuat i gruas ndikon negativisht edhe në sigurinë kombëtare.

Qeveria ka ngarkuar tej mase sektorin privat duke dhënë barrën kryesore për mbulimin e shpenzimeve të pushimit të lehonisë.

Kompensimi financiar me ligjin momental, jo vetëm që nuk promovon ngritjen e natalitetit, por në fakt i varfëron familjet, duke ju marrë të drejtën bazike për të bërë planifikim familjar dhe duke ndikuar negativisht në natalitet.



Centre for Research,  
Documentation and Publication



ODA EKONOMIKE E KOSOVËS | KOSOVA CHAMBER  
OF COMMERCE

**FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG**

Ky projekt është duke u realizuar nga: Qendra për Hulumtim Dokumentim dhe Publikim, në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës, dhe në partneritet me Friedrich Ebert Stiftung.



## SFIDAT

Krahasuar me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian (BE), Kosova nuk ka politika stimuluese për familjet që vendosin të kenë fëmijë.

Pushimi i lehonisë nuk është i transferueshëm në mes prindërve/kujdestarëve të fëmijut.

Implementimi i ligjit aktual të punës gjithashtu ka dështuar sa i përket aspektit se si i trajton gratë, duke e diskriminuar dhe më tutje.

Sektori privat nuk ka në dispozicion të gjithë fuqinë punëtore, duke rezultuar në shfrytëzim vetëm të gjysmës së potencialit të saj.

Numri i të rinjve në përgjithësi është gjithashtu në diskrepancë sa i përket participimit aktivë në punë në krahasim me moshat më madhore.

Mungesa e fuqisë punëtore me shkathtësi të veçanta (sipas nevojave të tregut të punës).

Kualifikimi i të rinjve nga institucionet arsimore, është në diskrepancë të madhe me nevojat e tregut.

Fuqia punëtore është e mbikualifikuar për nevojat e tregut të punës.

Sindikatë e dobët e cila nuk po arrinë të transferojë vendimet.

Humbja e kapaciteteve njerëzore, pas investimit nga kompanitë përkatëse private.

Mungesa e kulturës së punës.

Mungesa e përvojës reale të punës te punëkërkuetit potencial.

Ikja nga Kosova e kapitalit njerëzor.

Mungesa sistematike e meritokracisë.

# Rekomandimet

Ndryshimi i qasjes nga shteti dhe sektori privat sa i përket gruas, duke i dhënë vendin e merituar që i takon si qytetarë dhe akterë me rëndësi në evoluimin e familjes dhe shoqërisë, ngritjen e mëtutjeshme të shtetit si dhe avancimin e ekonomisë së tregut dhe konkurrencës.

Të krijohen politika strategjike zhvillimore të veçanta dhe të qarta me qëllim të punësimit të gruas pasi kjo është shumë e rëndësishme për interesin kombëtar.

Ngritja e një bashkëpunimi i të ngushtë publiko privat: Harmonizimi i sektorit publik me atë privat dhe hartimi i një plani strategjik i cili parasheh se çfarë kërkim tregu me qëllim të ofrimit të trajnimeve dhe arsimimit konform këtij plani; planifikim strategjik shtetëror lidhur me arsimim, trajnime dhe përgatitjen profesionale të të rinjëve për tregun vendorë; ngritja e një bashkëpunimi të ngushtë publiko privat, dhe në mes tyre dhe grave lidhur me amandamentimin e ligjit të punës.

Ligji i punës duhet të amandamentohet, për të reflektuar përgjegjësinë e shtetit në mbrojtjen e sigurisë njerëzore për qytetarët e tij, në këtë rast të gruas, dhe adresimin e sfidës që ka me rënien e natalitetit. Ligji i punës duhet të amandamentohet kryesisht në këto aspekte: Për të bartur përgjegjësinë primare të mbulimit financiar tek shteti, ndërsa përgjegjësia sekondare të jetë tek sektori privat; Për të rishikuar kompenzimin financiar për nënën në mënyrë që të adresohet varfërimi i familjes pas lindjes së fëmijës; që të konsiderohen politika stimuluese / beneficione për lindjen e fëmijës, të krahasueshme me rajonin dhe BE-në, për të stimuluar ngritjen e natalitetit; dhe mundësimin e transferueshmërisë së pushimit të lehonisë nga njëri prind tek tjetri.

Ligji për OJQ duhet të rishikohet dhe harmonizohet me ligjin e punës për të mbrojtur gratë edhe në sektorin e shoqërisë civile, konform ligjit të amandamentuar të punës.

Duhet pasur kujdes që mos të krijohen detyrimisht ligje të reja, si praktikë jo

efektive, por të amandamentohen ato aktuale duke dëshmuar dobësitë e tyre, përmes gjithëpërfshirjes së atyre që preken nga ligji respektiv.

Të konsiderohet rëndësia që kontrata kolektive të ketë qasje sektoriale, duke rekomanduar që aspektet e ndërlidhura të rregullohen brenda sektorit (punëdhënës-punëmarrës).

Fuqizimi i sistemit të drejtësisë, rendit dhe ligjit: Përmirësimi i kualitetit të kontratave në mes punëdhënësit dhe punëmarrësit, si dhe rregullimi me ligj dhe implemetimi konkret i masave ndëshkuese për shkeljen e kontratës.

Universitetet të kushtëzojnë mbajtjen e praktikës profesionale para diplomimit.

Tregu i punës të diversifikohet: Punëdhënësit duhet të ofrojnë fleksibilitet, të ketë oferta për të gjitha kategoritë e punëtorëve, tregu i punës të jetë më divers për të qenë në gjendje të absorboj kapacitete të ndryshme njerëzore.

## BURIMET:

### Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Kryetare: Duda Balje  
Zëvendëskryetare e parë: Lirije Kajtazi  
Zëvendëskryetare e dytë: Miljana Nikolić

#### Kontaktet:

Selman Ymeri  
Pozita: Koordinator  
Email-i:selman.ymeri@assembly-kosova.org  
Telefoni: 038 200 10 635

Sulltane Gashi

Pozita: Zyrtare e fushës  
Email-i:sulltane.gashi@assembly-kosova.org  
Telefoni: 038 200 10 624

### Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetare: Besa Baftiu  
Zëvendëskryetar i parë: Enver Hoti  
Zëvendëskryetare e dytë: Miljana Nikolić

#### Kontaktet:

Shpresa Haxhijaj  
Pozita: Koordinatore  
Email-i: shpresa.ramosaj@assembly-kosova.org  
Telefoni: 038 200 10 610;  
Muhamet Bytyçi  
Pozita: Zyrtar i lartë i fushës  
Email-i: muhamet.bytyci@assembly-kosova.org  
Telefoni: 038 200 10 616;

### Inspektorati i Punës

Basri Ibrahim - Kryeinspektor i IP-së  
Rr.Qamil Hoxha nr.30 - Prishtinë Kosovë  
Tel: 038 211-520 / 038 211-521  
e-mail: basri.ibrahimi@rks-gov.net

## QENDRA PER HULUMTIM DOKUMENTIM DHE PUBLIKIM (QHDP)

+377 45 321 545 | +386 49 350 693 | info@crdp-ks.org | www.crdp-ks.org

Adresa: Rr. Garibaldi, H.2, Nr.17, Prishtine, 10000, Republika e Kosovës

